

ADMINISTRATA DOGANORE SHQIPTARE

Newsletter | Shtator 2024

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I DOGANAVE TAKIM ME BIZNESIN NË DURRËS



Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, zhvilloi një takim me përfaqësues të biznesit në Durrës. Gjatë diskutimeve me anëtarët e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë ai u shpreh se Doganat mbeten të angazhuara në misionin e lehtësimit të procedurave doganore dhe mbrojtjes së tregtisë së ndershme.

“Në këto vite kemi ndryshuar tërësisht qasjen ndaj biznesit me filozofinë që Doganat janë një institucion që i shërben biznesit dhe që ka mision kryesor për të siguruar procedura doganore transparente dhe të parashikueshme, në funksion të realizimit të të ardhurave për buxhetin e shtetit,” u shpreh drejtori i Doganave, Genti Gazheli.

Ai e vuri theksin te digjitalizimi i shërbimeve doganore, teksa dha lajmin se brenda vitit të gjitha procedurat doganore do të jenë online nëpërmjet E-Albania. Ai i ftoi bizneset të aplikojnë për statusin e Operatorit Ekonomik të Autorizuar.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I DOGANAVE, GENTI GAZHELI TAKON DELEGACIONIN E UNODC

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli mirëpriti një delegacion të UNODC, (United Nations Office on Drugs and Crime) drejtuar nga Danilo Rizzi, përfaqësues Rajonal për Evropën Juglindore.

Forcimi i bashkëpunimit mes UNODC-së dhe Administratës Doganore Shqiptare, si dhe fushat e reja të bashkëpunimit në kuadër të Programit të ri Rajonal të UNODC-së për Evropën Juglindore 2024-2029, ishin temat kryesore që u diskutuan gjatë këtij takimi.



Programi Rajonal për Evropën Juglindore synon të ndërlihdë dhe të sinergjizojë përpjekjet programore të UNODC në Evropën Juglindore gjatë një periudhë 5-vjeçare nga 2024 deri në 2029 dhe mbështet aspiratat e rajonit për integrimin evropian.

DOGANA DIGJITALE



Drejtorja e Përgjithshme e Doganave i është bashkuar nismës së Qeverisë për të digjitalizuar shërbimet për qytetarët dhe bizneset, nëpërmjet platformës E-Albania. Digjitalizimi i sistemit doganor ka bërë që të krijohen lehtësi për biznesin, shkurtim të kohës procedurale, rritje e transparencës dhe ulje e nivelit të korrupsionit.

Vetëm gjatë muajit Shtator 2024 nga Administrata Doganore Shqiptare janë miratuar 472 shërbime online.

NIS NË DURRËS TRAJNIMI “MBI KONTROLLIN E ANIJEVE”, GAZHELI: BASHKËPUNIM I SHKËLQYER ME DOGANAT FRANCEZE

Në kuadër të asistencës së doganave franceze për Administratën Doganore Shqiptare nisi në ambientet e Komandës së Guardia di Finanza-s në Durrës trajnimi i punonjësve të Doganës Shqiptare “Mbi kontrollin e anijeve”



Drejtori Gazheli vlerësoi bashkëpunimin me Administratën Doganore Franceze: “Përfitoj nga rasti të vlerësoj me superlativa bashkëpunimin me Postin e Atasheut Doganor Francez dhe në veçanti gjatë periudhës që ky post drejtohet nga Z. Bergeon, ku intensiteti i asistencës së ndërsjellë ka arritur nivele të konsiderueshme,” tha ndër të tjera ai.

Drejtori i Doganave evidentoi se ky trajnim është mjaft i rëndësishëm edhe për faktin se tregtia më e madhe e vendit tonë (import-eksport) realizohet në rrugë detare, kryesisht ndërmjet Portit të Durrësit, Porto Romanos, Portit MBM, si dhe Portit të Vlorës.

EKSPERTËT E SEESAC, TAKIME ME DREJTUES TË DEGËVE DOGANORE NË RINAS, QAFË THANË DHE HANI I HOTIT

Një grup ekspertësh të SEESAC, shoqëruar nga specialistë të Drejtorisë Antitrafik të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, zhvilluan përgjatë një misioni 3-ditor takime me drejtues të degëve doganore në Rinas, Qafë Thanë dhe Hani i Hotit.



Gjatë këtij misioni të përbashkët u vlerësuan kapacitetet e Drejtorisë së Doganave për të edukuar kërcënimin e trafikut të paligjshëm të armëve të zjarrit, duke identifikuar nevojat specifike të shërbimeve doganore për të luftuar në mënyrë më efikase trafikun e armëve të zjarrit.

Rezultatet e këtij misioni vlerësimi do të shërbejnë si bazë për mbështetjen e mëtejshme të SEESAC (Qendra e Evropës Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta) në lidhje me pajisjet dhe asistencën teknike të nevojshme për të luftuar trafikun e paligjshëm të armëve të zjarrit.



A E DINI SE?

Aplikimi për Autorizim të Regjimit të Përpunimit Aktiv mund të kryhet nëpërmjet portalit e-Albania në:

- Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave
- Degën Doganore, për procedurë të thjeshtuar (riparime)

Kushtet kryesore:

- Të ekzistojë një nevojë reale (justifikim ekonomik i arsyeshëm) për përdorimin e regjimit
- Mallrat të jenë të identifikueshëm në produktin kompensues

Dokumentat e nevojshme pasqyrohen në faqen informuese të shërbimit